



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 256, Datë 09.09.2026

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 40, pika 2, gërma “ç” dhe 136, pika 2 të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 13, 16 dhe 14, pika 9, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 09.09.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1566/9 prot., datë 08.09.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 243, datë 02.12.2021, me afat vlefshmërie deri më 02.12.2026.
- Ajo ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1564/1 prot., datë 26.05.2026, brenda afatit të përcaktuar në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Gjatë shqyrtimit të aplikimit u konstatua se kishte ndodhur ndryshimi i ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e shoqërisë, pa autorizimin paraprak të ERE-s. Pas rakordimeve dhe korrespondencës me shoqërinë, me vendimin e bordit nr. 229, datë 10.08.2026, u vendos dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k.
- Në vijim, me vendimin nr. 232, datë 18.08.2026, bordi i ERE-s vendosi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së furnizimit me energji elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 18.08.2026 dhe 19.08.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të

tretët (data 28.08.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1566/7 prot., datë 20.08.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikim.
- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1566/8 prot., datë 28.08.2026, ka depozituar në ERE dokumentacion/informacion plotësues.
- Shoqëria disponon zyra parësore me kontratë qiraje deri më 26.12.2030, afat që nuk mbulon të gjithë periudhën e licencës deri më 02.12.2031, si dhe zyra dytësore me kontratë qiraje me afat të pacaktuar. Ajo ka deklaruar se, në rast përfundimi të së drejtës së përdorimit të adresës parësore, do të vijojë ushtrimin e veprimtarisë në adresën tjetër të deklaruar, e cila, në rast të përfundimit të së drejtës së përdorimit të adresës aktuale, do të deklarohet si adresa kryesore e ushtrimit të aktivitetit, me kryerjen e procedurave përkatëse pranë ERE-së dhe institucioneve kompetente. Në pikën 3.2.5, gërma a të Kushteve të licencës për furnizimin e energjisë elektrike, përcaktohet se i licencuari ka për detyrë të njoftojë ERE-n për çdo ndryshim të adresës. Për rrjedhojë, shoqëria e mbart këtë detyrim nga kushtet e licencës.
- Shoqëria ka dokumentuar se ka disa detyrime tatimore, të cilat janë objekt i një procesi gjyqësor në shqyrtim dhe për sa kohë çështja është në shqyrtim gjyqësor dhe nuk ka përfunduar me një vendim të formës së prerë, bordi vlerëson se shoqërisë duhet t'i vendoset detyrimi për të depozituar pranë ERE-s vendimin e formës së prerë të gjykatës, menjëherë pasi ta disponojë atë.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën nr. 494, Seria F21, të shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 243, datë 02.12.2021, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 03.12.2026.
2. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vendimin e formës së prerë të gjykatës në lidhje me detyrimet tatimore menjëherë sapo ta disponojë atë.
3. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të plotësimit/mosplotësimit të detyrimit të vendosur në pikën 2 të këtij vendimi.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k., OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI